



REPUBLIKA E KOSOVË - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E OBILIQIT OPSTINA OBILIC
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPSTE ADMINISTRACIJE



Udhëzues

Nr. 1/31
Dt.

27.09.2022
Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government



Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obiliq

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), nenit 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës si dhe nenit 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës nga DEFZH-ja, nr-IV-649, të dt.07.09.2022, në mbledhjen e mbajtur me dt.27.09.2022, mori këtë:

VENDIM

Për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajshme për vitin 2023

Neni 1

Normat Tatimore

Në zbatim të Ligjit Nr. 06/L-005, për Tatimin në Pronën e Paluajshme, neni 9, paragrafi 1, nën paragrafët 1.1 deri 1.9, Kuvendi Komunal i Komunës së Obiliqit cakton normat tatimore për vitin 2023 për të gjitha kategoritë e pronave, me përjashtim të kategorisë pronë publike, si vijon:

Kategoria e Pronës	Norma tatimore
Për njësitë bujqësore të parcelave	0.15 %
Për njësitë bujqësore të objekteve	0.15 %
Për njësitë pyjore të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të parcelave	0.15 %
Për njësitë rezidenciale të objekteve	0.15 %
Për njësitë komerciale të parcelave	0.25 %
Për njësitë komerciale të objekteve	0.25 %
Për njësitë industriale të parcelave	0.30 %
Për njësitë industriale të objekteve	0.30 %

Neni 2

Zbatimi

Obligohet Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim që të zbatoj këtë vendim.

Neni 3

Ky vendim shfuqizon vendimin Nr.- I-120 te datës 30.09.2020

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL-së, dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës, si dhe do të filloj së zbatuari nga dt: 01.01.2023.

T'i dërgohet

-Kryetarit

-Nënkryetarit

-Kryesueses

-Anëtarëve të Kuvendit

-DEFZH-Tatimit në Pronë

-Arkivit



Kryesuesja e Kuvendit komunal

Vlora Mjekiqi Kabashi